

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NR. ~~1908~~ REP.  
NR. ~~668~~ KOL.



**KONTRATE  
PER TRANSFERIMIN E KUOTAVE TE  
KAPITALIT TE SHOQERISE "ICEBERG PUBLICITY" SHPK.**

Sot ne Tirane, me date 09.06.2005, perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

- **Znj. Rafaela Rica**, lindur me 1976, banuese ne Tirane, mbajtese e pasaportes nr. 1769200, ortak i vetem i shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk., e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 22489, date 22.12.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane (me poshte quajtur "Shitesi");

dhe

- **Z. Pierre Semaan**, lindur me date 25.03.1963, ne Monrovia, Liberi, mbajtes i pasaportes nr. 2081132, banues ne adresen: "Kompleksi Rezidencial Chateau Linza, Tirane, Shqiperi" (me poshte quajtur "Bleresi");

**MEQENESE**

- a) **Shitesi**, ortak dhe administrator i vetem i shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk., e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendim nr. 22489, date 22.12.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, dhe me kapital themeltar 100.000 Leke, siç rezulton dhe vertetohet nga dokumentet e shoqerise dhe nga vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me siper, zoteron 100% te kapitalit te "Iceberg Publicity" Shpk.;
- b) **Shitesi** deshiron te transferoje 40 nga kuotat qe zoteron ne kete shoqeri, te cilat perfaqesojne 40% te kapitalit te saj;
- c) **Bleresi** deshiron te fitoje pronesine e 40 kuotave, qe perfaqesojne 40% te kapitalit te shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk.;

Palet bien dakort per sa me poshte vijon:

1. Objekti i Kontrates

- 1.1 Sipas kushteve te parashikuara ne kete Kontrate, Shitesi, zoterues i 100% te pjeseve te kapitalit te shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk., i transferon nepermjet shitjes Bleresit dhe ky i fundit blen nga Shitesi 40 kuota qe perfaqesojne 40% te kapitalit te Shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk.;
- 1.2 Shitesi i transferon (shet) Bleresit 40 kuota te zoteruara prej qe perfaqesojne 40% te kapitalit te shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk. kundrejt çmimit prej 40.000 (dyzete mije) Leke;
- 1.3 Bleresi deklaron dhe pranon transferimin e mesiperm te 40 kuotave te shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk. ne pronesine e tij.



### 2. Çmimi i shitjes

- 2.1 Kuotat e zoteruara nga Shitesi ne shoqerine "Iceberg Publicity" Shpk. transferohen (shiten) kundrejt nje çmimi prej 40.000 (dyzete mije) Leke, çmim per te cilin Bleresi nuk ka asnje pretendim.
- 2.2 Çmimi i shitjes si me sipër do t'i paguhet Shitesit nga ana e Bleresit menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate.

### 3. Garancite

- 3.1 Shitesi garaton se kuotat e kapitalit qe i transferon Bleresit jane te lira nga çdo barre apo pretendim tjeter ligjor i te treteve mbi to.
- 3.2 Bleresi i garanton Shitesit se pranon dispozitat e parashikuara ne statutin e shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk dhe garanton respektimin e plote te tyre.

### 4. Te ndryshme

- 4.1 Pas transferimit te kuotave te kapitalit tek Bleresi, ky i fundit fiton zoterimin e 40 kuotave, qe perfaqesojne 40% te pjeseve te kapitalit te shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk.
- 4.2 Me nenshkrimin e kesaj kontrate Shitesi humbet te drejten per ndarje dividendi, te drejten e votes dhe çdo te drejte tjeter qe rrjedh nga zoterimi i 40 pjeseve te kapitalit Shoqerise "Iceberg Publicity" Shpk. qe transferohen dhe Bleresi behet titullar i vetem i ligjshem i 40 kuotave te kapitalit te Shoqerise.

### 5. Baza Ligjore

- 5.1 Kjo kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe te ligjit nr. 7638 date 19.12.1992 "Per shoqerite tregtare"
- 5.2 Kjo kontrate hartohet ne 4 (kater) kopje, nje kopje per zyren e regjistrimit te shoqerive tregtare, nje kopje per t'u depozituar tek noteri nje kopje per secilen nga palet.

**Kjo kontrate pasi u lexua, prej meje Noterit, ne pranine e perkthyeses Oltina Dishnica, u gjet ne perputhje me vullnetin e lire e te plote te paleve, u nenshkrua rregullisht prej tyre ne pranine time dhe une Noteri e vertetoj kete sipas ligjit.**

Rafaela Rica

PALET

Pierre Samaan

